



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .11.2024

**MBLEDHJA Nr. 49,**  
**Datë 02.12.2024, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 02.12.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 49 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 25.11.2024.
2. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë të ditës në avancë.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “3AD ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “DESLA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “DESLA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**